# DËSHMI ARKIVI

**A-457153**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 6 prona të regjistruara me dokumente të dyshuara të falsifikuara, Prokuroria kërkon “arrest në burg” për Ertis Shehun |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/6-prona-te-regjistruara-me-dokumente-te-dyshuara-te-falsifikuara-prokuro-i587030` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 09:14:35 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 09:25:43 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `51b19c4aadb36f068b0a3cea557cf776bd32f1d331e2c4c4ab0cf224919cd1ce` |
| TEKSTI | `eb6165ece54069c65decfbabd67115a3084564edf6c24ad175683161f6e4c3d4` |
| PAMJA | `67b0ae79a723ddbe25024ce1cb8fa3d89ed4a45747962fca0543ee4aa953bb1e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `724e47e308e57921b04b13a8027d68e0255622f585a77add8049c12e2deb9a5b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/724e47e308e57921b04b13a8027d68e0255622f585a77add8049c12e2deb9a5b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# 6 prona të regjistruara me dokumente të dyshuara të falsifikuara, Prokuroria kërkon “arrest në burg” për Ertis Shehun


TemA

19 Shtator 2026, 11:25Kronika TEMA





Pas arrestimeve të kryera disa ditë më parë për një çështje pronash në Fier, Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për ish-drejtorin e ASHK-së, Ertis Shehu, dhe personin që dyshohet se ka përfituar pronat. Për një ish-hartograf të ASHK-së është kërkuar një masë më e lehtë sigurie.

Në qendër të hetimit janë gjashtë prona në zonën e Levanit, me një sipërfaqe totale prej rreth 71.7 hektarësh. Sipas Prokurorisë, dyshohet se këto prona janë regjistruar gjatë vitit 2023 duke përdorur dokumentacion të falsifikuar.

Bëhet fjalë për toka që lidhen me një vendim të vitit 2008, përmes të cilit ishte njohur e drejta e kompensimit për 100 hektarë tokë bujqësore në zonën e Levanit dhe Dërmënasit.

Një prej trashëgimtarëve, E.H., kishte marrë në vitin 2018 një kompensim financiar prej 53.8 milionë lekësh. Megjithatë, sipas hetimit, më vonë ai ka ndjekur procedurat për regjistrimin e gjashtë pronave, të cilat së bashku shtrihen në rreth 71.7 hektarë.

Prokuroria dyshon se në këtë proces kanë pasur rol edhe ish-drejtori i ASHK-së Fier, Ertis Shehu, dhe ish-hartografi i institucionit, duke lehtësuar regjistrimin e pasurive.

Pas regjistrimit, disa prej pronave dyshohet se janë shitur, duke gjeneruar të ardhura të konsiderueshme. Për këtë arsye, hetuesit po verifikojnë edhe transaksionet e kryera, lëvizjen e parave dhe destinacionin e tyre.

Në kuadër të hetimit janë sekuestruar edhe 715.976 euro në llogarinë bankare të E.H., ndërsa janë marrë për verifikim edhe dokumente dhe pajisje elektronike.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Vdekja pas lindjes e ish-bashkëshortes së futbollistit Alban Hoxha, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e 2 mjekëve

10:55 Kronika

Sekuestrohen mbi 400 kilogramë kanabis në frigorifer, arrestohet i riu shqiptar në Itali

10:18 Kronika

[Foto/ Tragjike në Greqi, si humbën jetën tre të rinjtë shqiptarë, nga aksidenti edhe dy të tjerë në gjendje kritike]

21:00 Kronika

[E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplaset për vdekje nga kamioni]

18:30 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.